

K O N T R A T E

Kjo Kontratë është lidhur sot më **09.10.2012** midis Komuna Mollas Elbasan me perfaqesues kryetarin z Agron Hysa, tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe "Blerimi shpk me NIPT J 62903384 G , me perfaqesues ligjor z Nazif Allani, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

1-Objekti i Kontrates : **Rehabilitim i kanaleve ujites sekondare , Komuna Mollas , sipas projekt zbatimit, preventivit fitues dhe specifikimeve teknike, qe gjenden ne DT**

2-Vlera e Kontrates : **25 377 042 (njezete e pese milion e treqind e shtatedhete e shtate mije e dyzete e dy) leke pa tvsh dhe 30 452 450 leke me tvsh**

2.1 Fondi i lekeve per kete kontrate eshte siguruar nga buxheti i shtetit nga grantet konkurruese , sipas shkreses se Komitetit te zhvillimit te Rajoneve

3-Baza Ligjore : Ligji 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" V.K.M nr.1 date 10.01.2007 "Per Miratimin e Regullave te Prokurimit Publik", I ndryshuar, Udhezimet e Agjensise se Prokurimit Publik per dokumentacioni standart te prokurimeve, Ligji 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Kodi Civil I R.SH , Kodi i Procedurave Administrative .

4-Afati i fillimit te punimeve do te jete e nesermja e celjes se nje pjese se fondeve nga buxheti i shtetit ne llogarine e komunes ne degen e thesarit dhe ajo e mbarimit te punimeve do te jete jo me vone se 60 dite. (ne total dite pune ne kantier jo me shume se 60 dite)

5-Te drejtat dhe detyrimet e paleve.

5.1-Te drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktor.

1-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e fillimit të punimeve të shprehur në pikën 4 të kësaj kontrate . Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

2-Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

3- Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.



4-Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

5- Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

6-Pagesat do të behen siç specifikohet në kushtet e vecanta të kontratës.Pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare . Pagesa do të behet ne nr e llogarise te kontraktuesit , pas paraqitjes se situacionit te konfirmuar nga supervizori i caktuar nga autoriteti kontraktor

7-Autoriteti kontraktor nuk do të paguaje paradhenie .

8- Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

9-Garanci e difekteve do të mbahet ne masen 5% te vleres se cdo situacioni te paraqitur nga kontaktuesi , per nje periudhe 1 (nje) vit nga data e perfundimit te objektit sipas dates se procesverbalit te marrjes ne dorezim te punimeve.

5.2.Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit:

1- Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje të plote me projektin e zbatimit , afatin dhe me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

2- Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë me levrimin e keshtit te pare nga buxheti i shtetit ne llogarine e komunes dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

3- Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë si dhe ruajtjen e mjedisit të gjitha aktivitetëve në kantier.

4- Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

5-Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor .

6- Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

6-Te Pergjithshme.

1-Kontrata do të rregullohet , interpretohet dhe zbatohet sipas baze ligjore qe ka shebyer si baze per lidhjen e saj dhe me gjere te ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

2-Bashkengjitur kesaj kontrate do te jene:

-Formulari i kontrates me dokumentacionin perkates shoqerues e te specifikuara ne te ,

-Kushtet e pergjithshme te kontrates;

-Kushtet e vecanta te kontrates;



-Preventivi fitues

- Sigurimi i kontrates

7-Zgjidhja e mosmarveshjeve.

1-Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marveshje me negociata direkte.

2-Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor

Komuna Mollas

K R Y E T A R I

Agron Hysa




Kontraktuesi

Blerimi shpk

ADMINISTRATORI

Nazif Allani



FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: , Rehabilitim i kanaleve ujites sekondare , Komuna Mollas

Kjo Kontratë është lidhur më 09.10.2012. midis Komunes Mollas Elbasan , perfaqesuar nga kryetari z. Agron Hysa , tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe Blerimi shpk me NIPT J 62903384 G , me perfaqesues ligjor z Nazif Allani, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit **Rehabilitim i kanaleve ujites sekondare , Komuna Mollas** Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 17.09.2012, bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e pergjithshme te Pranimi/Kualifikimit
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej 25 377 042 leke pa tvsh dhe 30 452 450 leke me tvsh , për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë:

Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: 3 045 245 leke dhe në formën e: shoqerise se sigurimit , në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

1. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
2. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
3. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
4. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 09.10.2012, palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Autoriteti Kontraktor

Kontraktues

Komuna Mollas

Blerimi shpk

K R Y E T A R I

ADMINISTRATORI

Agron Hysa

Nazif Allani

